



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 15 regjistër (JR)
Datë 17.04.2024

Nr. 20 i vendimit
Datë 26.02.2026

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare

mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, ditën e enjte, më datë 26.02.2026, në orën 15:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Arjela Vllaçaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 15/2024 (JR), datë 17.04.2024, që i përket:

ANKUESE: 1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Mimoza Margjeka, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

2. Komisionerja Publike, znj. Irena Nino.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 739, datë 26.02.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: 1. **Për ankimin e subjektit të rivlerësimit:**
Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 2/2014.

2. **Për ankimin e Komisioneres Publike:**
Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, e cila kërkoi prishjen e vendimit nr. 739, datë 26.02.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, analizoi pretendimet e ngritura në ankim nga Komisionerja Publike, e cila kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 739, datë 26.02.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) dhe deklarimin e procesit të përfunduar pa një vendim përfundimtar dhe, pas kalimit procedural, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në bisedimet përfundimtare, kërkoi deklarimin e përfunduar të procesit të rivlerësimit për znj. Mimoza Margjeka pa një vendim përfundimtar, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Rezarta Schuetz, dhe e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Mimoza Margjeka (referuar në vijim “subjekti i rivlerësimit” dhe/ose “subjekti”), në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016, ka ushtruar detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Për rrjedhojë, ajo u përfshi në rrethin e subjekteve që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Referuar vendimit objekt ankimi të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar brenda afatit deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit (në vijim “deklarata *vetting*”) në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), deklaratën për kontrollin e figurës në Drejtorinë për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”)¹.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Me vendimin nr. 739, datë 26.02.2024, Komisioni vendosi të shkarkojë nga detyra e gjyqtarit subjektin e rivlerësimit, znj. Mimoza Margjeka.
 - 3.1. Referuar vendimit objekt shqyrtimi, nëpërmjet gjetjes së datës 16.3.2023, vëzhguesi ndërkombëtar ka vënë në dispozicion të Komisionit vendimin nr. {***}, datë 15.12.2022, të Gjykatës së Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për dënimin e subjektit të rivlerësimit për veprën penale të korrupsionit pasiv kryer në bashkëpunim. Po ashtu, me të njëjtin opinion e gjetje, vëzhguesi ndërkombëtar potencoi që sjellja e subjektit të rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë dhe vendimi i gjykatës duhet të konsiderohet nga Komisioni në vlerësimin e përgjithshëm të subjektit dhe marrjen e një vendimi i cili është i pavarur nga hetimet që kryhen nga organet e tjera.
 - 3.2. Komisioni administroi sa më sipër dhe i bëri pjesë të rezultateve të hetimit administrativ me të cilat njohu subjektin në datën 25.04.2023. Komisioni, po ashtu, konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka shkelur standardet e sjelljes së gjyqtarit, të cilat duhet të jenë shumë më të larta se ato të shoqërisë

¹ Këto deklarata nuk janë dërguar në Kolegj.

në tërësi, duke treguar mungesë integriteti në zbatim të ligjit dhe pasi sjellja e saj reflekton mbi sistemin gjyqësor. Mbi këtë bazë, Komisioni vlerësoi se sjellja e subjektit të rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe i kaloi barrën e provës.

3.3. Në përgjigje të rezultateve të hetimit në datën 03.05.2023, subjekti i rivlerësimit parashtroi se nuk kishte ende vendim penal të formës së prerë që ajo të konsiderohet e dënuar, sipas nenit 462 të Kodit të Procedurës Penale dhe i dërgoi Komisionit ankimin që kishte ushtruar ndaj vendimit të shkallës së parë. Subjekti, po ashtu, theksoi edhe respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, sanksionuar nga neni 30 i Kushtetutës, duke potencuar se asaj i kishte kaluar barrë prove për të provuar pafajësinë në kuadër të procesit të rivlerësimit dhe kërkoi nga Komisioni pezullimin e shqyrtimit derisa çështja të merrte zgjidhje nga organet kompetente me vendim penal të formës së prerë.

3.4. Në datën 04.05.2023, mbi bazën e kërkesës së subjektit, Komisioni vendosi pezullimin e procesit në pritje të një vendimi nga Gjykata e Posaçme e Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Kjo e fundit, në datën 29.01.2024, i vuri Komisionit në dispozicion dispozitivin e vendimit nr. {***}, datë 12.12.2023, nëpërmjet të cilit u la në fuqi vendimi i shkallës së parë. Komisioni i bëri pjesë të rezultateve të hetimit të dy vendimet penale.

3.5. Përpos gjetjes së sipër-referuar, të datës 16.03.2023, vëzhguesi ndërkombëtar ka dërguar në Komision edhe një gjetje e mendim të dytë, në datën 16.01.2024. Nëpërmjet tyre, vëzhguesi ndërkombëtar parashtroi se vendimet e gjykatave penale duhet të konsiderohen brenda kuadrit të vlerësimit të përgjithshëm, bazuar në standardet e përshtatshme të etikës, që rregullojnë funksionin e gjyqtarit. Gjithashtu, ai është shprehur se pavarësia dhe autonomia e institucioneve të rivlerësimit, është thelbësore për sistemin e vënë në zbatim nga neni 179/b i Kushtetutës dhe nga Aneksi i saj. Sipas vëzhguesit ndërkombëtar, fati i procesit të rivlerësimit, për një subjekt, nuk mund t'i nënshtrohet procedimeve të tjera disiplinore ose administrative të zakonshme, pasi do të pengonte dhe zhvleftësonte qëllimin e procesit të rivlerësimit dhe duhet të konsiderohet gjithashtu, si antikushtetues.

3.6. Në datën 29.01.2024, Komisioni i dërgoi subjektit rezultate të hetimit administrativ. Komisioni konstatoi se sjellja e subjektit të rivlerësimit bie ndesh me Parimet e Bangalores për mënyrën e sjelljes që pritet nga një gjyqtar dhe ka konkluduar se sa është provuar nga vendimi penal për subjektin çon në përfundimin e shkeljes së standardeve të sjelljes së një gjyqtari, duke cenuar besimin e publikut te drejtësia.

3.7. Në datën 05.02.2024, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht pranë Komisionit² dhe paraqiti një relacion të sajën si përgjigje për *shkresën që i njoftoi rezultatet e hetimit*. Përpos pretendimit se kërkesa e ONM-së për informacion nga gjykata përbën intimidim dhe ndërhyrje për dhënien e një vendimi në disfavor të saj, subjekti ka referuar edhe që Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) ka caktuar datën e seancës dëgjimore për të shqyrtuar kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “ILD”) për hetimin disiplinor në ngarkim të saj. Për këtë arsye, subjekti i kërkoi Komisionit që të vijojë pezullimin e procesit të rivlerësimit deri në marrjen e një vendimi nga KLGj-ja. Subjekti, përsëri, është shprehur se barra e provës i ka kaluar për të provuar pafajësinë për procesin penal në ngarkim të saj. Në përfundim, subjekti i kërkoi Komisionit që të vazhdojë

² Subjekti, po ashtu, rezultoi të ketë marrë edhe një kopje të CD-së me aktet në dosje.

pezullimi për shkak se dy procedurat janë mbivendosur dhe në rast vendimi shkarkimi nga KLGj-ja, procedura e Komisionit do të duhet të ndërpritet.

3.8. Në datën 22.02.2024, Komisioni vendosi të mos e pranojë kërkesën e dytë të subjektit për vijimin e pezullimit, duke referuar në mbështetje autonominë e organeve të rivlerësimit. Në të njëjtën datë, trupi gjykues i Komisionit caktoi datën e zhvillimit të seancës dëgjimore më 26.02.2024. Pas këtij komunikimi, pavarësisht njoftimeve postare apo elektronike, subjekti nuk konfirmoi marrje dijeni. Po ashtu, subjekti nuk u paraqit në seancën e caktuar.

3.9. Komisioni vijoi me zhvillimin e seancës në mungesë, në kushtet kur subjekti nuk kishte paraqitur kërkesë për shtyrje apo shkaqe që e pengonin të paraqitej. Përfundimisht, në datën 26.02.2024, Komisioni mori vendimin për shkarkimin e subjektit nga detyra. Për shkak të dënimit penal me vendim të formës së prerë, të cilin e konsideroi në kuadër të një vlerësimi të përgjithshëm, Komisioni arriti në konkluzionin se veprimet e subjektit të rivlerësimit kanë cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

4. Kundër vendimi të Komisionit ka ushtruar ankim në Kolegj subjekti i rivlerësimit dhe Komisionerja Publike, përkatësisht në datat 2 dhe 3 prill 2024. Nëpërmjet ankimit të nënshkruar nga avokatja Margarita Kola³, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar prishjen e vendimit të Komisionit dhe dërgimin për rigjykim. Komisionerja Publike ka kërkuar përfundimin e procesit të rivlerësimit *pa* një vendim përfundimtar për subjektin e rivlerësimit. Ankimet respektive i janë komunikuar rregullisht palëve.

III/1. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit

4.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor nga Komisioni, meqenëse ajo nuk është njohur me vendimin e marrë për kërkesën e dytë të saj për pezullimin e procesit. Po ashtu, subjekti pretendon se nuk u njoftua në adresën që kishte lënë në dispozicion të Komisionit, për datën dhe orën e seancës dëgjimore.

4.2. Sipas subjektit, zhvillimi i seancës dëgjimore në mungesë cenon vlefshmërinë e procesit. Ajo pretendon se nuk shprehu një qëndrim për themelin e çështjes, duke iu cenuar e drejta për të ushtruar një mbrojtje efektive, për akses në gjykatë, si dhe për t'u dëgjuar.

4.3. Shkarkimi nga detyra pa një vendim të formës së prerë, dhënë nga Gjykata e Lartë, cenon të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Subjekti ka depozituar në Kolegj edhe rekursin e ushtruar ndaj vendimin të Gjykatës së Apelit të Posaçëm, si provë të re në ankim.

4.4. Subjekti pretendon se vendimmarrja e Komisionit tejkalon kompetencat dhe, sipas saj, Komisioni nuk është organi që mund të shkarkojë subjektet e rivlerësimit, në kuadër të një procesi penal, por KLGj-ja. Për pasojë, subjekti pretendon se nuk u gjykua nga një gjykatë e krijuar me ligj, dhe se, as KLGj-ja nuk mund të vendosë shkarkimin pa një vendim të Gjykatës së Lartë.

III/2. Shkaqet e ankimit të Komisioneres Publike

³ Ankimi është nënshkruar edhe nga subjekti i rivlerësimit, por nënshkrimi i subjektit është i fotokopjuar/jo origjinal.

4.5. Komisionerja Publike kërkon nga Kolegji ndryshimin e vendimit të Komisionit, duke potencuar se për shkak të humbjes së statusit të magistrates procesi i rivlerësimit për subjektin duhet të përfundojë pa një vendim përfundimtar. Komisioni nuk gëzonte *ratione materiae* për shqyrtimin e kësaj çështje të mbetur pa objekt. Në themel të pretendimeve të Komisioneres Publike qëndron argumenti se Komisioni nuk mund të ushtrojë juridiksionin kontrollues pa hetuar, *së pari*, për mënyrën sesi ka proceduar KLGj-ja. Komisioni nuk mund të marrë vendimin për shkarkimin e subjektit bazuar vetëm në vendimin penal të Gjykatës së Apelit të Posaçëm – këtë kompetencë Kushtetuta ia ka ngarkuar KLGj-së.

4.6. Komisionerja Publike propozon, gjithashtu, që Kolegji të kërkojë informacion nga organet e juridiksionit të zakonshëm disiplinor nëse në zbatim të kompetencave të tyre ato kanë shkarkuar subjektin nga detyra apo janë në kushtet e mosveprimit. Sipas Komisioneres, nëse KLGj-ja është në kushtet e mosveprimit, zbatimi i drejtpërdrejt nga Kolegji i nenit 140/2/a⁴ të Kushtetutës, për efekt të kryerjes së procesit të rivlerësimit, duhet të sjellë pasojën e deklarimit të përfunduar të procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegji

i. Juridiksioni i Kolegjit

5. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit edhe të Komisioneres dhe duke mos qenë në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

ii. Legjitimimi i ankuesve

6. Subjekti i rivlerësimit dhe Komisionerja Publike legjitimohen (*ratione personae*), në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe (*ratione temporis*), pasi ankimet janë depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes

7. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit {***}, të Komisionit, duke qenë se një nga palët që ka ankuar vendimin është edhe Komisionerja Publike, kryhet në seancë gjyqësore publike. Trupi gjykues i shqyrtoi në të njëjtin proces të dy ankimet. Ndërsa dy seancat gjyqësore publike të caktuara në datat 13.11.2025 dhe 15.12.2025 u shtynë me kërkesë të subjektit të rivlerësimit, seanca e datës 10.02.2025 u zhvillua në prani vetëm të

⁴ 2. Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur: “a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës; [...]”.

përfaqësuesit të autorizuar të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme⁵, z. Adnan Xholi⁶. Duke konstatuar që subjekti nuk paraqiti asnjë arsye për mungesën e saj, ndonëse në dijeni të seancës së caktuar në datën 10.02.2026, sikurse dhe kishte qenë personalisht në Kolegj një ditë përpara seancës për t'u njohur me fashikujt e dosjes, dhe pasi dëgjoi përfaqësuesin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, trupi gjykues vendosi të zhvillojë gjykimin në mungesë të saj.

A/1. Aspekte procedurale të gjyimit të çështjes në Kolegj

8. Trupi gjykues e çmoi të panevojshëm kërkimin e informacionit nga KLGj-ja për procesin disiplinor të kryer për subjektin, pasi në dosjen e krijuar në Kolegj, mbi bazën e ankimit të subjektit⁷, gjendej edhe vendimi disiplinor për shkarkimin⁸ e saj, për shkak të vendimit penal. Konkretisht, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Kolegj edhe ankimin kundër vendimit të KLGj-së, nën dritën e tagrave që ka Kolegji në juridiksionin disiplinor, sipas Kushtetutës⁹. Ky akt, pjesë e fashikullit në procesin disiplinor në Kolegj, u administruan në çështjen konkrete gjyqësore.

8.1. Nga aktet në fashikull rezulton se më datë 15.12.2022, subjekti i rivlerësimit është shpallur fajtor për veprën penale të *korruptionit pasiv* të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 319/ç e 25 të Kodit Penal dhe është dënuar me katër vjet e gjashtë muaj burgim. Kjo masë është zëvendësuar me tre vjet shërbim prove dhe heqjen e të drejtës së ushtrimit të funksioneve publike për pesë vjet. Vendimi i mësipërm është lënë me në fuqi dhe ka marrë formë të prerë në datën 12.12.2023, me vendimin e Gjykatës së Apelit të Posaçëm¹⁰. Nëpërmjet burimeve të hapura zyrtare, Kolegji erdhi në dijeni se në datën 11.12.2025, me vendimin nr. {***}, Gjykata e Lartë, vendosi mospranimin e rekursit të ushtruar nga subjekti i rivlerësimit ndaj vendimit të dënimit, duke lënë kështu në fuqi vendimet e dy gjykatave më të ulëta¹¹.

8.2. KLGj-ja, me vendimin nr. 180, datë 09.04.2024, ka shkarkuar nga detyra subjektin e rivlerësimit, pasi ka kryer një proces disiplinor prej mbi dy muajsh, nisur kryesisht nga ILD-ja në datën 21.12.2023. Pasi shqyrtoi ankimin e subjektit të rivlerësimit kundër këtij vendimi, në kuadër të juridiksionit disiplinor, me vendimin nr. 1 (JD), datë 27.01.2026, Kolegji vendosi të lerë në fuqi

⁵ Në përputhje me nenin 179/b, pika 8 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 199, paragrafi i 2-të i Kodit të Procedurës Civile, u krye kalimi procedural nga Komisionerët Publikë të Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kundër Korruptionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK).

⁶ Sipas tagrave të pasqyruara në autorizimin nr. {***} prot., datë 06.11.2025.

⁷ Pasi Kolegji ka disponuar me kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare me vendimin (JD) nr. 1/1, datë 29.07.2024, palët respektive (ankuesja, KLGj-ja dhe ILD-ja) paraqitën në Kolegj parashtrimet dhe provat me shkrim, përfshirë vendimin nr. 180, datë 09.04.2024, të KLGj-së, për shkarkimin e subjektit.

⁸ Vendimi i sipër-referuar i KLGj-së, bazuar në nenin 140, pika 2, shkronja "b" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 104, pika 3 dhe 111, pika 1, shkronja "b" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

⁹ Neni 179: "[7.] Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar gjyqtarët e Kolegjit të Apelit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kolegji i Apelit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë. [...]".

¹⁰ Me vendimin nr. {***}, të Gjykatës së Apelit Kundër Korruptionit dhe Krimit të Organizuar (në vijim "Gjykata e Posaçme e Apelit"), i cili ka lënë në fuqi vendimin nr. {***}, të Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korruptionit dhe Krimit të Organizuar.

¹¹ Vendimi i Gjykatës së Lartë në <https://gjykataelarte.gov.al/sq/lajme/publiku/informacion-i-ceshtjeve-penale-date-11.12.2025> për "Mospranimin e rekurseve të paraqitura nga të gjykuarit A. C., Mimoza Margjeka, K. Zh. dhe S. D., kundër vendimit nr. {***} ({***}), datë 12.12.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar".

vendimin e KLGj-së që shkarkoi subjektin nga detyra. Ky vendim iu njoftua palëve, u botua në fletoren zyrtare dhe hyri në fuqi në datën 10.02.2026, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 26 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

8.3. Sikurse referuar më sipër, në seancën e parë të zhvilluar në Kolegj, në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit, në datën 13.11.2025, subjekti i rivlerësimit kërkoi shtyrjen e seancës për shkak të pamundësisë objektive të përfaqësueses së saj ligjore për të marrë pjesë e realizuar mbrojtjen. Pas dakordësisë edhe të përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, trupi gjykues e shtyu seancën për në datën 15.12.2025.

8.4. Në seancën e dytë të caktuar në datën 15.12.2025, subjekti i rivlerësimit paraqiti një kërkesë të re për shtyrje, kësaj radhe për shkak të pamundësisë objektive për të marrë pjesë ajo vetë, për arsye shëndetësore të fëmijës së saj. Trupi gjykues i Kolegjit e pranoi edhe këtë kërkesë, duke e shtyrë seancën për në datën 10.02.2026 dhe theksuar që subjekti të merrte masat për të mundësuar dhënien e qëndrimit të saj personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor, dhe shmangur zvarritjet. Subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit as në seancën e datës 10.02.2026, pa asnjë shpjegim, ndonëse kishte qenë e pranishme fizikisht në Kolegj një ditë më herët dhe kërkuar akte nga fashikulli, të cilat iu dorëzuan në të njëjtën ditë pas disa orësh në banesë. Në këto kushte, pasi dëgjoi edhe përfaqësuesin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, z. Adnan Xholi, trupi gjykues i Kolegjit vendosi të vijojë gjykimin e çështjes në mungesë, duke moskonstatuar asnjë shkak ligjor apo objektiv për mungesën e subjektit të rivlerësimit.

8.5. Në të njëjtën datë, subjekti i rivlerësimit depozitoi në Kolegj një kërkesë për përjashtimin e gjithë anëtarëve të trupit gjykues. Referuar nenit 75 të Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues vijoi me seancën e caktuar¹². Në kushtet që subjekti nuk plotësoi elementet formalë të evidentuar nga Kolegji brenda afatit të përcaktuar për këtë qëllim¹³, kjo kërkesë u arkivua.

A/2. Parashtrimet në Kolegj

9. Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti parashtrime në kuadër të ushtrimit të mbrojtjes së saj në Kolegj. Nga ana tjetër, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, duke iu qëndruar shkaqeve të ankimit, në parashtrimet e tij në seancën publike të zhvilluar në datën 10.02.2025, paraqiti kërtime alternative: *ndryshimin* e vendimit të Komisionit dhe deklarimin e procesit të rivlerësimit të përfunduar për subjektin pa një vendim përfundimtar, për shkak të humbjes së statusit të magjistratit ose *lënien* në fuqi të vendimit të Komisionit, në rast se organet e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë vepruar sipas parashikimeve kushtetuese.

¹² Neni 75 i Kodit të Procedurës Civile, paragrafi i gjashtë parashikon: “[...] Në këto raste gjykimi nuk pezullohet, por gjyqtari nuk mund të japë ose të marrë pjesë në dhënien e vendimit, derisa të jepet vendimi që e deklaroi të papranueshme ose që e rrëzon kërkesën e përjashtimit”.

¹³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 10.02.2026, “Kthim përgjigjeje” dhe shkresën nr. {***} prot., datë 12.02.2026, “Kthim përgjigjeje”, Kolegji ka informuar subjektin se bazuar në pikën 3 të nenit 15 të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese”, kërkesat me objekt kërkitim përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi i çështjes, paraqiten veçmas, të ndara. Subjektit i është dhënë kohë një afat dyditor; në të kundërt kërkesa arkivohet. Ajo ka marrë dijeni personalisht në datat 10.02.2026 dhe 12.02.2026, për nevojën dhe afatin për të kryer veprimet e plotësimit/ndarjes së kërtimeve.

9.1. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme potencoi nevojën e kryerjes së verifikimit dhe administrimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor i akteve nëpërmjet të cilave të evidentohet nëse është marrë masa disiplinore e shkarkimit nga detyra ndaj subjektit. Në varësi të përgjigjes mbi këtë pyetje, sipas parashtrimeve të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, Kolegji duhet të ndryshojë vendimin objekt shqyrtimit të Komisionit dhe të deklarojë procesin e rivlerësimit kalimtar të përfunduar pa një vendim përfundimtar. Në mënyrë alternative, në rast se KLGj-ja nuk ka vepruar, referuar me analogji vendimit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. M. A. [(JR) nr. {***}/2025], Kolegji duhet të lerë në fuqi vendimin e Komisionit.

9.2. Në vijim të sa më sipër, me vendim të ndërmjetëm, Kolegji bëri pjesë të dosjes së juridiksionit të rivlerësimit vendimin e KLGj-së [referuar më sipër] dhe vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit (JD) nr. 1, datë 27.01.2026, botuar në fletoren zyrtare nr. 31, datë 10.02.2026¹⁴, që la në fuqi vendimin e mësipërm të KLGj-së. Këto akte administroheshin nga Kolegji -- për pasojë ishte e panevojshme që të kryhej hetim për akte nga KLGj-ja.

9.3. Pasi u njoh me këto akte, në bisedimet përfundimtare, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në referim të nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 739, datë 26.02.2024 të Komisionit dhe deklarimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të përfunduar pa një vendim përfundimtar.

B. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit për themelin e çështjes

10. Në përfundim të analizës së kryer mbi bazën e akteve në fashikull, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në rrethanat konkrete faktike procesi i rivlerësimit për subjektin nuk duhet të vazhdojë, pasi ajo ka humbur statusin e magjistrates me një vendim të KLGj-së që ka marrë formë të prerë. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

10.1. *Së pari*, për sa i përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit që kanë natyrë procedurale, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në kushtet që çështja u shqyrtua në seancë publike, dhe subjektit iu dha mundësia të ishte e pranishme e paraqiste argumentet e saj, aspektet e procesit të rregullt, që, sipas saj, janë cenuar nga vendimmarrja e Komisionit, prezumohen të tejkaluara. E thënë ndryshe, edhe duke i konsideruar të mirëqena pretendimet e saj për mosnjohim të seancës në adresën e specifikuar prej saj, me shqyrtimin e ankimit në seancë publike, dijenia e të cilës për subjektin është përtej çdo kontesti, procesi është shëruar automatikisht. Për më tepër, Kolegji shtyu dy seanca për t'i lejuar subjektit të jetë e pranishme e të realizojë mbrojtjen në mënyrën e zgjedhur prej saj. Nga ana tjetër, nga një verifikim i akteve në fashikull, procedura e ndjekur nga Komisioni rezulton të ketë qenë në përputhje me standardet e procesit të rregullt ligjor. Komisioni ka pezulluar procesin e rivlerësimit në pritje të vendimmarrjes nga gjykatat penale. Nga ana tjetër, adresa e përdorur për komunikimet nga Komisioni ka qenë e saktë dhe efikase dhe pa asnjë problem kontaktimi, përfshirë edhe në datën 05.02.2024, kur subjekti ka përcjellë kundërshtimet për rezultatet e hetimit. Në këto akte, subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar ndryshim të vendndodhjes. Duket se ndryshimi është bërë evident duke nisur nga data 22.02.2024, kur Komisioni i ka dërguar subjektit lajmërim për

¹⁴ <https://qbz.gov.al/eli/fz/2026/31/9ee24e98-9837-428a-ac01-d8fe4007b948>

seancën publike të caktuar në datën 26.02.2024¹⁵. Me fjalë të tjera, ky pretendim i subjektit është i pabazuar. Pavarësisht dhe duke abstraguuar nga ky konstatim, këto pretendime u vlerësuan pa relevancë për zgjidhjen e çështjes nën dritën e fakteve të reja dhe të kërkimit në bisedimet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

10.2. Në shkurt të vitit 2024, kur Komisioni ka marrë vendimin objekt shqyrtimi, subjekti ishte e pezulluar nga detyra me një vendim të KLGj-së [nr. {***}, datë 14.09.2020] dhe njëkohësisht ishte dënuar me vendim penal të formës së prerë për një krim. Ndërkohë, vendimi i KLGj-së, për shkarkimin nga detyra është marrë në prill 2024, dhe si pasojë e vendimit të Kolegji¹⁶ për mospranimin e ankimit të subjektit kundër tij, ka hyrë në fuqi më 10.02.2026. Në këtë vendim të Kolegjit, peshë e veçantë i është kushtuar edhe vendimit të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit të paraqitur nga subjekti, si pasojë e të cilit [mospranimi], edhe ndonjë diskutim i mbetur për pasojat ligjore të tij [formën e vendimit penal, e prerë apo jo], mbeti pa objekt e pa peshë. Po ashtu, si pasojë e të njëjtave fakte ligjore, edhe vendimi i KLGj-së për shkarkimin e subjektit nga detyra dhe humbjen e statusit të magjistrates u konfirmua edhe në Kolegj.

10.3. Germa “b” e pikës 2 të nenit 140 të Kushtetutës parashikon se: “Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur: [...] b) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi”. Qartazi dhe në mënyrë të shprehur, KLGj-ja ka tagrin për konstatimin e rasteve që përbëjnë shkak për shkarkimin nga detyra. Lexuar në harmoni me nenin 64 të ligjit nr. 96/2016, për shkaqet për të cilat statusi i magjistratit mbaron, dhe me germën “dh”¹⁷ të pikës 1 të nenit 105 të të njëjtit ligj, ndër të tjera kur: “[d] shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji¹⁸; [...]”, masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, e dhënë nga këshilli përkatës ndaj magjistratit, përbën një ndër rastet e humbjes së statusit të magjistratit. Një ndër shkaqet e shkarkimit nga detyra, pasuar me humbjen e statusit të magjistratit, është edhe dënimi me një vendim penal të formës së prerë, parashikuar nga Kushtetuta. Mbarimi i menjëhershëm i ushtrimit të detyrës së një gjyqtari, ndodh kur subjekti nuk kalon me sukses procesin e rivlerësimit, si dhe në rast se konstatohen “shkaqet e tjera” të parashikuara në Kushtetutë, që shoqërohen nga vendimmarrje të organit kompetent¹⁹, që në rrethanat konkrete është KLGj-ja.

10.4. Mbarimi i ushtrimit të detyrës, për shkak të vendimit penal në ngarkim të subjektit në referencë të dispozitave të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 96/2016, është detyrë ekskluzive [në rastin konkret] e KLGj-së, vendimi i të cilës u la në fuqi nga Kolegji. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit përgjatë kohës midis ushtrimit të ankimit dhe shqyrtimit të çështjes në Kolegji ka humbur statusin e magjistratit, sipas germës “b” të pikës 2 të nenit 140 të Kushtetutës, me vendim të këshillit kompetent që ka marrë formë të prerë. Kjo ngjarje, lexuar në mënyrë harmonike me qëllimin për të cilën u ngrit procesi i rivlerësimit dhe me rrethin e subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sjell për pasojë pamundësinë e Kolegjit që të vijojë rivlerësimin kalimtar në ngarkim të këtij subjekti rivlerësimi. Për këtë shkak, e në konsideratë edhe të kërkimeve në bisedimet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së

¹⁵ Konkretisht, subjekti është kontaktuar dhe ka konfirmuar marrjen e njoftimeve në adresën: rruga “{***}”, pall. {***}, {***}, sh. {***}, kt. {***}, {***}, Tiranë. Referuar akteve në fashikullin e Komisionit, nr. {***} prot., datë 22.02.2024, me vulën e shërbimit postar për mosdorëzimin pasi marrësja “është larguar”.

¹⁶ Shih <https://kpa.al/wp-content/uploads/2026/02/Vendimi-JD-nr.-I-Mimoza-Margjeka-anonimizuar.pdf> dhe Fletoren Zyrtare nr. 31, datë 10.02.2026 në: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2026/31/9ee24e98-9837-428a-ac01-d8fe4007b948>

¹⁷ I. Këshillat mund të vendosin një ose më shumë nga këto masa disiplinore: [...] dh) shkarkim nga detyra.

¹⁸ Sipas pjesës V, Kreu I, i ligjit nr. 96/2016 - Përgjegjësia Disiplinore, Civile dhe Penale.

¹⁹ Ligji nr. 96/2016, në nenin 66, pika 4, ka parashikuar: Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit.

Posaçme, gjykimi i çështjes në Kolegj ka mbetur *pa* objekt. E vetmja alternativë për zgjidhjen e kësaj çështjeje, mbetet deklarimi i përfunduar i procedurës pa një vendim përfundimtar, për shkak se qëllimi dhe objekti për të cilin ka nisur ky proces është bërë i pamundur.

10.5. Aneksi i Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016 nuk kanë parashikuar ndonjë rregullim të posaçëm për situatën faktike të përshkruar më lart. Si pasojë, trupi gjykues i Kolegjit vëren se duhet të zbatohet pika 6 e nenit 4 e ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet se: *“Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji”*.

10.6. Në kushtet kur në momentin e gjyimit të çështjes, bazuar në analizën e mësipërme, objekti dhe qëllimi i procesit të rivlerësimit kalimtar të znj. Mimoza Margjeka është bërë i pamundur, trupi gjykues i Kolegjit, në vijim të konstatimeve të mësipërme, vlerëson se zgjidhja e çështjes duhet të bëhet sipas parashikimit të nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, i titulluar “Pamundësia në objekt apo qëllim”, i cili parashikon se: *“Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”*.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, për subjektin e rivlerësimit, znj. Mimoza Margjeka, pa një vendim përfundimtar për çështjen, për shkak se objekti dhe qëllimi i këtij procesi është bërë i pamundur.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, sot më datë 26.02.2026.

ANËTARE
Albana SHTYLLA
nënshkrimi

ANËTARE
Ina RAMA
nënshkrimi

ANËTAR
Sokol ÇOMO
nënshkrimi

RELATORE
Rezarta SCHUETZ
nënshkrimi

KRYESUESE
Natasha MULAJ
nënshkrimi